



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

Tiranë më 04/08/2020

V E N D I M

Nr. 47, Datë 04/08/2020

Në zbatim të Ligjit Nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 786, datë 09.11.2016 “Për procedurat e përzgjedhjes dhe rastet e shkarkimit të anëtarëve si dhe rregullat e organizimit e të funksionimit të Bordit të Mbikëqyrjes Publike”, Statutit të Bordit të Mbikëqyrjes Publike, si dhe në mbështetje të Rregullores nr. 1, datë 26.07.2017 “Për mbledhjen e të ardhurave të Bordit të Mbikëqyrjes Publike”, ndryshuar, Bordi i Mbikëqyrjes Publike sipas rendit të ditës së njoftuar paraprakisht:

V E N D O S I:

1. Bordi i Mbikëqyrjes Publike lëshon vërtetime sipas kërkesës brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga data e pagesës së tarifës prej 2,500 (dymijë e pesëqind) lekë në llogarinë bankare të BMP-së.
2. Të gjithë subjektet, Auditues Ligjor dhe/ose Shoqëri Auditimi, të cilët kërkojnë pajisjen me vërtetim nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike, do të pajisen me vërtetim, pasi të kenë shlyer të gjitha detyrimet financiare ndaj Bordit të Mbikëqyrjes Publike, si dhe/ose çdo detyrim tjetër si rezultat i një mase disiplinore.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar
Dritan FINO



Anëtar
Adriana BERBERI

(Adriana Berberi)

Anëtar
Edlira LUÇI

()

Anëtar
Luan ABAZI

(Luan Abazi)

Anëtar
Klement MERSINI

(Klement Mersini)